

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 08-254/3
 Data/Datum/Date: 13/10/2020
 Shtojca/Dodaci/Annex: -4-



PRISHTINË/A **Republika e Kosovës**
Republika - Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
 Departamenti për Profesione të Lira - Departmant Slobodnih Profesija - Department of
 Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Diciplinska Komisija/ The Disciplinary Comitee

Nr.07//2020

KOMSIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUES PRIVAT, në përbërje të Xhemil Elshani kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj Përmbaruesit Privat _____ si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore _____ dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, të LPP-së, dhe nenet 110 par. 2 dhe 3 si dhe neni 111 par. 1 i LPK-së, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë për profesionet e lira- Divizioni për Noteri dhe Përmbarues privat Fadilete Hoxha në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore të palës ankuese _____ të cilën e përfaqësojnë _____ me prezencën e përmbaruesit privat _____ pas mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim të mbajtur me dt. 23.09.2020, muar këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtarë i Ministrisë së Drejtësisë –Departamenti për profesione të lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbaruesit Privati DPL. 07/2020 të dt. 26.03.2020, dhe ankesa e palës ankuese _____ nga Prishtina, të dt. 10.03.2020, si e pa bazuar.

II.Organi Përmbarues- Përmbaruesi Privat _____ nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduara nga neni 367 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 të LPP-së, sipas lëndës përmbarimore P.nr. 268/16 të dt. 16.12.2016

A r s y e t i m

Pranë Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë, me dt. 26.03.2020 ka parashtruar kërkesën për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat [.....] si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore [.....] për shkeljen disiplinore nga neni 367 par. 1 nënpar.1.1 dhe 1.2, të LPP-së, dhe nenet 110 par. 2 dhe 3 si dhe neni 111 par. 1 i LPK-së [.....] bazuar në ankesën e ankuesit [.....] nga Prishtina, të dt. 10.03.2020 sepse përmbauesi privat në këtë rast me rastin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale përmbaimore sipas lëndës P.nr. 268/16 të dt. 16.12.2016 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit të procedurës përmbaimore ashtu që nuk i ka dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit aktvendimin për përmbaimit urdhërin për t'i ju dhënë mundësinë e ushtrimit ose jo të mjetit të rregullt juridik, por ka lëshuar urdhër për inkasim të borxhit, dhe pas inkasimit të borxhit i cili ishte propozuar për përmbaimit debitori parashtron ankesë në gjykatë, dhe gjykata e aprovon ankesën si të bazuar, ndërsa gjatë zhvillimit të procedurës përmbaimore debitori [.....] parashtron kundër përmbaimit duke e fituar të drejtën e tij.

Ministria e Drejtësisë – Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbauesit Privat me dt.26.03.2020 ja ka paraqitur komisionit disiplinor propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat [.....] si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore [.....], i dyshuar për shkelje disiplinore e nga nenet 367 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 të LPP-së, sepse i njejt me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbaimore sipas lëndës së përmbaimit P.nr. 268/16 të dt. 16.12.2016 ka shkelur ligjin e përmbaimit si dhe ka tejkalluar autorizimet e tija ligjore, ku i ka rekomanduar marrjen e masës disiplinore ndaj përmbauesit privat.

Në kuptim të dispozitave të nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014 komisioni disiplinor ka caktuar seancën dëgjimore me dt. 23.09.2020 në ambientet- zyrat e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë të gjitha palët në procedurë, si ankuesi- [.....] nga Prishtina përfaqësuesit të saj [.....] nga Prishtina, përmbauesi privat [.....], si dhe përf. i Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për noteri dhe përmbaues privat Fadilete Hoxhaj në cilësinë e iniciuesit të procedurës disiplinore.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me 23.09.2020 kryesuesi i komisionit disiplinor në fillim të seancës dëgjimore ja ka dhënë mundësinë shkelësit disiplinor të pretenduar respektivisht përmbauesit privat që të deklarohet lidhur me përgjegjësinë disiplinore për pranimin e përgjegjësisë në pajtim me nenin 7 par. 3 të UA-MD.nr.09/2014 për procedurën disiplinore me çrast përmbauesi privat ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduar.

Përf. i autorizuari i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për profesione të lira- Divizioni për noteri dhe përmbaues privat Fadilete Hoxhaj, në fillim të seancës dëgjimore ka bërë shpjegimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat [.....] duke theksuar se mbetet pranë pretendimeve të theksuara me shkrim, se përmbauesi privat [.....] ka bërë shkelje disiplinore nga 367 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2, të LPP-së, sepse

i njejtë me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore sipas lëndës P.nr. 268/16 të dt. 16.12.2016 me veprimet e tija ka bërë shkelje ligjore sepse ka tejkaluar autorizimet ligjore të tij.

Ankuesi nga Prishtina, përfaqësuesit të saj gjatë seancës dëgjimore disiplinore ka theksuar se organi përmbarues – përmbaruesi privat me veprimet e tija përkitazi me përmbarimin e çështjes përmbarimore sipas lëndës P.nr. 268/16 ka shkelur ligjin e procedurës së përmbarimit dhe ka tejkaluar autorizimet e tija ligjore respektivisht i njejtë ka deklaruar se ka ngelur pran propozimit të përfaqësuesit të Ministrisë, se i njejtë gjatë ushtrimit të detyrës së përmbaruesit ka bërë shkelje ligjore të cilat shkelje më vonë janë konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata Themelore dhe nga Gjykata e Apelit në Prishtinë me çrast ankuesi në këtë rast është dëmtuar materialisht e në kuptim të gjithë kësaj kërkon nga komisioni disiplinor që ndaj përmbaruesit privat të ndërmerren të gjitha veprimet ligjore që janë në proporcion me shkeljet e bëra nga i njejtë. Vlera e dëmtimit që është shkaktuar ankuesit me veprimet e kundërligjshme të përmbaruesit është vlera në shumë prej 2.686.83 euro, ku përmbaruesi privat gjatë dorëzimit të shkresave debitorit nga Peja ka bërë shkelje gjatë dorëzimit të propozimit ku në këtë moment kanë filluar edhe shkeljet ku në emër të borxhit- shpenzimeve të energjisë elektrike dhe shpenzimet tjera ka inkasuar shumë e lartpërmendur në emër dhe llogari të ngelim pranë kërkesës që ndaj të njëjtit të shqiptohet masë disiplinore.

Përmbaruesi privat gjatë seancës dëgjimore disiplinore të datës së lartpërmendur ka deklaruar se me pranimin e propozimit të dt. 16.12.2016 si zakonisht kam lejuar përmbarimin, kam caktuar përmbarimin me datën e njejtë dhe kemi dërguar urdhërin mbi caktimin dhe lejimin e përmbarimit të debitorit, i cili e ka refuzuar pranimin duke u bazuar në vendimet e lartpërmendura të marura nga e gjykatave të lartpërmendura, duke mos ditur se ai është liruar vetëm nga veprimet penale ndërsa nga obligimet tjera civile i njejtë nuk është liruar. Me dt. 22.02.2017 për herë të dytë përmbaruesi ja dërgon palës debitorë vendimin mbi caktimin dhe lejimin e përmbarimit, ku i njejtë përsëri ka refuzuar pranimin duke deklaruar se ai e ka përfunduar gjykimin për këto çështje, dhe nuk e njeh përmbaruesin dhe as veprimet e tija. Mbas këtij momenti në tabelën e shpalljeve kam vendosur aktvendimin për përmbarim siç parasheh ligji me çrast edhe pas kalimit të afatit ligjor është vendosur përkitazi për prapësimin.

Komisioni disiplinor pas përfundimit të seancës dëgjimore, të të gjitha palëve në procedurë, si dhe pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të njëjtave, veç e veç dhe të gjithave së bashku si dhe provave tjera të parashtruara me qëllim të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje. Ka ardhur në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë dhe se përmbaruesi privat me rastin e përmbarimit të çështjes përmbaruese të lartpërmendur, nuk ka bërë shkelje disiplinore me rastin e zbatimit të LPP-së, si dhe as që ka bërë tejkalim të autorizimeve ligjore lidhur me çështjen në fjalë- çështjes përmbarimore P.nr. 268/16, nuk është gjetur se ka kryer shkelje disiplinore në këtë çështje përmbarimore për shkak se gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore i njejtë i është përmbajtur dhe i ka zbatuar dispozitat e ligjit të procedurës përmbarimore.


Andaj më sa u tha më lartë e duke vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 4 par. 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ- MD.nr. 09/2014, dhe nenit 374 par. 1 të LPP-së, komisioni disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL.nr.07/20 me dt. 23.09.2020

Kryetari i Komisionit Disiplinor

Xhemil Elshani



KËSHILLI JURIDIK : Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar sipas nenit 374 par. 5 të LPP-së.